



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 09.07.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9636, DATË 6.11.2006, “PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT”

- **Hyrje**

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **09.07.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”*”

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e përfaqësuar nga Znj. **Mira Rakacolli**, Zëvendësministre

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, rritjen e monitorimit të duhanpirjes në Republikën e Shqipërisë, sigurimin e mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga produktet e duhanit dhe forcimin e rolit monitorues të inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë, në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga duhani.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me aktet ndërkombëtare.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Ky projektligj është përafruar me direktivën 2014/40/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, prezantimin dhe shitjen e

duhanit dhe produkteve të lidhura me të dhe shfuqizimin e Direktivës 2001/37/KE”, e ndryshuar”.

- **Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2019-2020**

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitulli 28: “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit”** të Planit Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2019-2020.

- **ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT**

- Neni 70 i MSA-së njih rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Europian;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit Europian;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

- **ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT**

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

1. Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Kreu 3 “Përafrimi i legjislacionit” **neni 114, pika 3** (ish-neni 95 TKE), Titulli XIV “Shëndeti publik”, **neni 168** (ish-neni 152 TKE), Titulli XV “Mbrojtja e konsumatorit”, **neni 169** (ish-neni 153 TKE).
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Titulli VI “Përafrimi i legjislacionit, imponimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës”, **neni 76** “Mbrojtja e konsumatorit”.

2. Legjislacioni dytësor i BE-së:

Direktiva 2014/40/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, prezantimin dhe shitjen e duhanit dhe produkteve të lidhura me të dhe shfuqizimin e Direktivës 2001/37/KE”, e ndryshuar

3. Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

- **Konsultimi publik**

Në mbledhjen e Komisionit për Integrimin Europian nuk ka patur përfaqësues të shoqërisë civile apo të grupeve të interesit

- **Efektet financiare të aktit**

Ky projektligj nuk do të ketë efekte shtesë financiare në buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i projektligjit shoqërohet me kosto, e cila është brenda tavaneve buxhetore, të miratuara për vitin përkatës,

- **Diskutimi në komision**

Nga komisioni u vlerësuan bashkëpunimi risitë e këtij projektligji.

- **Ndryshime të projektaktit (nen për nen)**

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa ndryshime si vijon:

Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- ***Direktivën 2014/40/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, prezantimin dhe shitjen e duhanit dhe produkteve të lidhura me të dhe shfuqizimin e Direktivës 2001/37/KE”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32014L0040, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.127, datë 29.4.2014, fq.1-38.***

2. Në nenin 1 pika 2 të projektligjit i cili parashikon që në ligjin në fuqi në nenin 3 të shtohen pikat 19-36, pika 21 riformulohet si vijon:

“21. “Duhan për llullë” nënkupton duhanin që mund të konsumohet nëpërmjet procesit të djegies dhe vetëm për qëllim përdorimi me llullë”.

3. Në nenin 1 pika 2 të projektligjit i cili parashikon që në ligjin në fuqi në nenin 3 të shtohen pikat 19 - 36, pika 29 riformulohet si vijon:

“29. Produktet e reja të duhanit” nënkuptojnë produktet e duhanit që:

a) nuk bëjnë pjesë në asnjë nga kategoritë e mëposhtme si: cigare, duhan kaush/për t’u dredhur, **duhan për llullë**, duhan për nargjile, puro, cigarillo, duhan për përtypje, duhan për thithje me hundë, duhan për përdorim nga goja;

b) vendosen në treg pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”

- **KORRIGJIMI I TABELAVE TË PËRPUTHSHMËRISË QË SHOQËROJNË PROJEKTLIGJIN**

Tabelat e përputhshmërisë konsatohet të jenë sipas kërkesave ligjore

Përfundim

- Komisioni për Integrimin Europian:
- pasi vlerësoi qëllimin e projekligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
- pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
- pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
- pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe me ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

NËNKRYETARE

SENIDA MESI